

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË “AGA SOLAR” SH.P.K)**

Sot, ne date 22.11.2021 me vullnet te lire u hartua kontrata e kalimit te kuotave nepermjet shitjes, midis paleve:

SHITES:

1. **“GENESIS PROJECTING” SH.P.K**, e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi të subjektit NIPT L57017205G, perfaqesuar nga administratori **Arkond Canaj** sipas vendimit te asamblese nr8, date 22.11.2021
2. Shoqeria **“ARDENO” SH.P.K.** e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi të subjektit NIPT K11804001T,perfaqesuar nga administratori **Tonin Alia** sipas vendimit te asamblese nr.7, date 22.11.2021
3. Shoqeria **“Albin -TROS 2011” SH.P.K** , e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi të subjektit NIPT L13510201L, perfaqesuar nga administratori **Ilmi Pupuleku** sipas vendimit te asamblese nr.6, date 22.11.2021

BLERES:

4. SHOQERIA **“METEO” SH.P.K.**, e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi të subjektit NIPT L26310801C, perfaqesuar nga administratori **Erind Bengu** sipas vendimit te asamblese nr.5, date 22.11.2021

1.

TE DHENA PARAPRAKE:

- (a) Shitësit jane titullar te **100% (njqind %)** te kapitalit themeltar të shoqërisë **“AGA SOLAR” SHPK** me NIPT M11415029E me status aktiv, ne te cilen zoterojne perkatesisht nga nje kuote te barabarte me:
 - **Shitesi “GENESIS PROJECTING” SH.P.K- zoteron 34% te kapitalit**
 - **Shitesi “ARDENO” SH.P.K.- zoteron 33% te kapitalit**
 - **Shitesi “Albin -TROS 2011” SH.P.K.- zoteron 33 % te kapitalit**
- (b) Me vendimin nr.3 date 22.11.2021 bashkelidhur Asambleja e Ortakeve te shoqerise kuotat e se ciles shiten, ka miratuar shitjen e **1 kuote te zoteruar nga te tre shitesit te barabarte me 10%** te kapitalit te shoqerise, nga ortaket shites ne favor te blesesit sipas ketij akti.
- (c) Me vendimin bashkelidhur Asambleja e shoqerise **“ARDENO” SH.P.K.** dhe **“Albin -TROS 2011” SH.P.K** kane miratuar shitjen te blesesi te **3% secili pjese te kapitalit** qe ato zoterojne ne shoqerine **“AGA SOLAR ” SHPK** duke caktuar edhe administratorin si personin e ngarkuar per nenshkrimin e aktit te kalimit te kuotes.
- (d) Me vendimin bashkelidhur Asambleja e shoqerise **“GENESIS PROJECTING” SH.P.K** ka miratuar shitjen te blesesi te **4% pjese te kapitalit** qe ai zoterojne ne shoqerine **“AGA SOLAR ” SHPK** duke caktuar edhe administratorin si personin e ngarkuar per nenshkrimin e aktit te kalimit te kuotes.
- (e) Nga verifikimi ne regjistrin e barreve siguruese rezulton se kuota e kapitalit objekt i ketij transaksioni jane te lira dhe nuk ka pengesa per tjetersimin e tyre.

- (f) Me vendimin bashkelidhur Asambleja e shoqërise Blerese ka miratuar **blerjen e nje kuote te shoqërise "AGA SOLAR"** SHPK te barabarte me 10% te kapitalit te saj, duke caktuar edhe administratorin si personin e ngarkuar per nenshkrimin e aktit te kalimit te kuotes.
- (g) Bleresi deklaron se e njej gjendjen e shoqërise, e ka verifikuar ate dhe e pranon kalimin e 10% te kapitalit kuotes se ortakut shites sipas parashikimeve ne kete akt.

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATES

- 1.1** Objekt i kësaj kontrate është realizimi i shitjes nga Shitësit te Blerësit, ne total i 10 % (dhjete përqind) te kapitalit të shoqërisë Aga Solar, dhe zhveshja e shitesve nga te drejtat qe burojne mbi keto pjese perkatesisht:
- **Shitesi "GENESIS PROJECTING" SH.P.K** nga momenti i nenshkrimit te ketij akti, zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qënia ortak në shoqëri mbi 4% te kapitalit te shoqërise;
 - **Shitesi "ARDENO" SH.P.K.** nga momenti i nenshkrimit te ketij akti, zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qënia ortak në shoqëri per pjesen 3 % te kapitalit.
 - **Shitesi "Albin -TROS 2011" SH.P.K** nga momenti i nenshkrimit te ketij akti, zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qënia ortak në shoqëri per pjesen 3 % te kapitalit.
- 1.2** Pas realizimit te ketij transferimi nepermjet shitjes me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi shoqëria **"METEO" SH.P.K,** behet zoterues i plote dhe i ligjshme e 1 kuote, dhe pjeses se zoteruar prej tij, qe perben 10 % te kapitalit themeltar te shoqërise **"AGA SOLAR"** shpk.
- 1.3** Pas kalimit te pjeseve te kapitalit te shoqërise "Aga Solar" shpk, ne favor te Blerësit, ne menyren e percaktuar ne kete akt ortakët do te zoterojne perkatesisht keto pjese kapitali ne shoqërine "Aga Solar":
- Shoqëria **"GENESIS PROJECTING" SH.P.K.,** e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi të subjektit NIPT L57017205G, perfaqesuar nga administratori **Z. Arkond CANAJ,** me 30% te kuotave.
 - Shoqëria **"ARDENO" SH.P.K.,** e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi të subjektit NIPT K11804001T, perfaqesuar nga administratori **Z. Tonin Alia** me 30% te kuotave
 - Shoqëria **"Albin -TROS 2011" SH.P.K.,** e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi të subjektit NIPT L13510201L, perfaqesuar nga administratori **Z. Ilmi Pupuleku.** me 30% te kuotave
 - Shoqëria **"METEO" SH.P.K.,** e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi të subjektit NIPT L26310801C, perfaqesuar nga administratori **Erind Bengu** me 10% te kuotave

NENI 2



ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësi i detyrohet Shitësit për blerjen e saj është në vlerë monetare ne total ne masen 10.000 leke (dhjete mije leke), vlere te cilen pala blerese do ta likujdoje ne marreveshje te plote midis paleve .

NENI 3 BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;

NENI 4 GARANCITE

- 4.1 Shitesi posedon kuotat e lira nga cdo barre siguroese, peng, hipoteke, garanci pagese, barre mbi interesat, kufizim, opSION, pretendim, prokure apo angazhime te tjera te cdo lloj natyre.
- 4.2 Nenshkrimi i kesaj kontrate nga shitesi dhe plotesimi i kushteve te saj nuk perbejne shkelje apo jane ne kundërshtim me normat e (i) statutit te shoqerise, (ii) ndonje gjykim apo urdher, vendim gjyqsor, dekreti apo vendimi te cdo autoriteti vendas apo te huaj subjekt i te cilit eshte shitesi, (iii) ndonje marreveshje, licence apo angazhim ne te cilin keta shites apo shoqeria eshte pale, qe do te cenonte aftesine e tij per te nenshkruar kete kontrate apo per te permbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj, (iv) me ligjin e zbatueshem
- 4.3 Bleresit deklarojne se paraprakisht kane verifikuar gjendjen financiare te shoqerise dhe kane dijeni te plote ne lidhje me detyrimet dhe gjendjen e saj financiare dhe deklarojne se njohin dhe pranon te blejne kuotat e mesiperme me te gjitha te drejttat dhe detyrimet qe shoqeria ka ne perpjestim me perqindjen e kuotave, duke mos pasur asnje pretendim nga shitesit per periudhen qe ka qene ortak tani dhe ne te ardhmen.

NENI 5 DATA EFEKTIVE E KONTRATËS

- 5.1 Kjo kontratë është e përvokueshme, e pakthyeshme, efektive, e detyrueshme për palët dhe trashëgimtarët e tyre, që nga data e nënshkrimit të saj.

NENI 6 ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 6.1 Asnjë nga palët nuk mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë.

NENI 7 HARTIMI I KONTRATËS, AKTET BASHKËLIDHUR

- 7.1 Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje të barazvlefshme, në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.
- 7.2 Kontratës i bashkëlidhen aktet e mëposhtme:
- vendimet e Asamblese se shoqerive pjesemarrese.
- **RBS te gjendjes se kuotave te kalipalit**
- kopje të dokumenteve të identifikimit të palëve.

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua prej Palëve kontraktuese; të cilët pasi deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht dhe pa verejtje.


PALET KONTRAKTUESE

SHITES



"GENESIS PROJECTING" SH.P.K, e
perfaqesuar nga administratori Arkond Canaj



Shoqeria "ARDENO" SH.P.K."
perfaqesuar nga administratori Tonin Alia



Shoqeria "Albin -TROS 2011" SH.P.K
perfaqesuar nga administratori Ilmi Pupuleku



BLERES

SHOQERIA "METEO" SH.P.K.,
perfaqesuar nga administratori Erind Bengu

